

KUD 336

PASQYRAT FINANCIARE DHE LLOJET E TYRE

*Msc. Fidane Spahija,
fidane.spahija@gmail.com*

Abstrakt

Pasqyrat financiare janë raporte që u lejojnë palëve të interesuara që të vlerësojnë profitabilitetin dhe solventitetin e ndërmarrjes. Këto raporte të kontabilitetit ofrojnë informata të përgjithësuara për shfrytëzuesit dhe ndihmojnë ndërmarrjen të din gjendjen reale të saj dhe të marrin vendime konkrete. Që një pasqyrë të jetë e dobishme kryesisht, duhet të jetë: e kuptueshme, e besueshme, përkatëse, e krahasueshme, etj. Kemi këto lloje të pasqyrave financiare: Bilanci i gjendjes, pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimit në kapital dhe pasqyra e rrjedhës së parasë. Bilanci paraqet gjendjen e pasurisë, detyrimeve dhe kapitalit për një periudhë të caktuar kohore. Pasqyra e rrjedhës së parasë tregon raportin në mes të të hyrave dhe shpenzimeve duke rezultuar me fitimin neto për një periudhë të caktuar kohore. Pasqyra e ndryshimit të kapitalit paraqet përmbledhjen e fitimeve të mbajtura të korporatës për periudhën specifike kohore. Dhe së fundi, pasqyra e rrjedhës së parasë paraqet përmbledhjen e të pranuarave të gatshme (cash) dhe pagesave për periudhën specifike kohore;

Fjalët kyçe: Pasqyrë financiare, llojet, raport, periudhë.

JEL kualifikimi: G1, G10, G19.

1. Hyrje

Me këtë punim shkencor bëhen përpjekje të sqarohen: Njohuritë mbi definimin dhe karakteristikat e pasqyrave financiare, si dhe llojet e tyre duke i paraqitur me shembuj konkret. Për hartimin e punimit janë përdorur literatura të ndryshme vendore dhe të huaja, poashtu hulumtime në internet, media elektronike dhe të shkruara. Metodat e përdorura për të arritur qëllimin e punimit kryesisht janë: analitike, krahasuese, abstraksionit, etj.

2. Çka janë pasqyrat financiare?

Pasqyrat financiare janë raporte që u lejojnë palëve të interesuara që të vlerësojnë profitabilitetin dhe solventitetin e ndërmarrjes. Këto raporte të kontabilitetit të quajtura pasqyra financiare, ofrojnë informata të përgjithësuara për

=====

shfrytëzuesit dhe janë të dedikuara për shfrytëzim të brendshëm dhe të jashtëm.⁷⁶ Pasqyrat financiare janë si fotografi e gjendjes së ndërmarrjes për një periudhë të caktuar kohore.⁷⁷

2.1. Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare

Disa nga karakteristikat cilësore që e bëjnë të dobishëm informacionin për të dhënë përdoruesi në pasqyrat financiare, sipas SNK-ve janë:⁷⁸

- **Kuptueshmëria** – është cilësia bazë e informacionit të dhënë në pasqyrat financiare. Duke e parë se çdo dite e më tepër po ka tendenca të zhvillimit të rregullave të kontabilitetit dhe kjo shkon në drejtim që informacioni kontabël të jetë sa më i kuptueshëm edhe për individët që nuk merren me fushën e kontabilitetit. Kuptueshmëria si cilësi kryesore e informacionit kontabël nuk nënkupton se të dhënat komplekse nuk duhet të paraqiten, sepse një informacion kontabël vlen vetëm atëherë kur është i plotë dhe shërben si bazë për marrjen e vendimeve racionale nga përdoruesit e informacionit kontabël.
- **Përkatësia** – e informacionit kontabël është gjithashtu veti e rëndësishme, e cila e bën informacionin të dobishëm për përdoruesin e tij. Informacioni posedon cilësinë përkatëse nëse ai i ndihmon përdoruesit në marrjen e vendimeve të drejta lidhur me ngjarjet e shkuara, të tashme dhe të ardhshme të biznesit. Natyra dhe materialiteti i informacionit kontabël ndikon në masë të madhe në përkatësinë e informacionit kontabël.
- **Besueshmëria** – konsiston në atë se kur informacioni kontabël është pa gabime dhe shtrembërime, përdoruesit mund ta përdorin në marrjen e vendimeve sepse raporton besnikëri atë të cilën e ka synuar ta paraqesë. Që një informacion të jetë i besueshëm duhet të paraqet besnikëri në të gjitha transaksionet e ndodhura të periudhave të ndryshme. Që të jetë informacioni i besueshëm në pasqyra financiare, duhet të jetë neutral, pa shtrembërime dhe i përgatitur me kujdes duke i vlerësuar në mënyrë arsyeshme pasiguritë dhe rreziqet të cilat mund ta përcjellin biznesin. Paraqitja e plotë e informacionit kontabël brenda kufijve të materialitetit e bën atë të besueshëm.
- **Krahasueshmëria** – u mundëson përdoruesve të vlerësojnë tendencat në gjendjen dhe rezultatin e firmës. Përdoruesit kanë mundësi të krahasojnë pasqyrat financiare të ndërmarrjes në

⁷⁶ Dr.sc. Skender Ahmeti: “Kontabiliteti financiar”, Prishtine, 2008, fq.41.

⁷⁷ Ligjeratë e autorizuar e Prof. Mr. Drita Shoshi.

⁷⁸ Dr.sc. Rrustem Asllanaj: “Kontabiliteti financiar”, Prishtine, 2010, fq.48.

=====

mënyrë që të vlerësojnë ndryshimet relative në gjendjen financiare dhe rezultatin ekonomik të tyre. Që të bëhet krahasueshmëria me pasqyrat financiare gjatë periudhave të ndryshme apo me pasqyrat financiare të firmave tjera, informacioni i raportimit financiar duhet të përcillet me njoftime shitesë lidhur me politikat kontabël të përdorura në ndërtimin e pasqyrave financiare.

3. Llojet e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare paraqiten në disa forma:

- **Bilanci i gjendjes**– paraqet një listë të aseteve, të detyrimeve dhe të ekuitit të pronarëve për periudhën specifike kohore;
- **Pasqyra e te ardhurave** – paraqet përmbledhjen e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën specifike kohore;
- **Pasqyra e rrjedhave të parasë (cash flow)** – paraqet përmbledhjen e të pranuarave të gatshme (cash) dhe pagesave për periudhën specifike kohore;
- **Pasqyra e ndryshimeve në kapital (fitimit të mbajtur)** – paraqet përmbledhjen e fitimeve të mbajtura të korporatës për periudhën specifike kohore.

Këto pasqyra përbëjnë tiparin kryesor të kontabilitetit sepse ato janë mjetet e para të komunikimit dhe të informimit kontabël, si dhe produkti final i analizave dhe transaksioneve kontabël të biznesit.⁷⁹

3.1. Bilanci i gjendjes

Bilanci raporton në formë të përmbledhur gjendjet (saldot) e llogarive të pasurisë, kapitalit të vet dhe detyrimeve të biznesit në datën e ndërtimit të tij për një periudhë të caktuar kohore. Data e ndërtimit të bilancit është fundi i periudhës fiskale, por ndërmarrjet e mëdha e përpilojnë atë edhe në periudha njëmujore, tremujore, gjashtëmujore, etj. Rregulla e bilancit të gjendjes është se totali i pasurisë duhet të jetë i barabartë me totalin e kapitalit dhe të detyrimeve. Kjo mund të shprehet edhe me anë të ekuacionit si në vijim:⁸⁰

$Pasuria = Kapitalin (Ekuitin) + Detyrimet$

Ky ekuacion quhet ekuacion themelor i bilancit. Nëse i referohemi elementeve të përfshira në ekuacionin e bilancit, atëherë rrjedh se nëpërmjet

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Dr.sc. Rrustem Asllanaj: “Kontabiliteti financiar”, Prishtine, 2010, fq.50.

tij raportohen: pasuria, kapitali dhe detyrimet e entitetit. Këto tri elemente kryesore të bilancit duhet të raportohen të klasifikuara me klasa të veçanta, në mënyrë që përdoruesit të kuptojnë me lehtësi situatën financiare të firmës. Kështu p.sh. pasuria afatgjatë është më pak likuide në krahasim me pasurinë afatshkurtër, prandaj ato në bilanc raportohen në kategori të veçanta. E njëjta gjë vlen edhe për detyrimet.

Egzistojnë dy formate që përdoren për prezantimin e bilancit:

- Formati vertikal në formë të raportit,
- Formati horizontal ose në formë të llogarisë T.

Formati vertikal, për përgatitjen e bilancit, kryesisht përdoret në praktikë, kurse formati horizontal përdoret për studime sepse kuptohet më lehtë nga individët që merren me studimin e kontabilitetit.⁸¹

Bilanci kryesisht duhet t'i përmbajë këto cilësi: Emri i entitetit; Emri i pasqyrës financiare si bilanc; Data e përpilimit të bilancit; Njësia monetare, në të cilën janë matur kategoritë e tij, etj.

Në vijim paraqitet një shembull i bilancit të gjendjes:⁸²

Pasuria		Detyrimet dhe Kapitali	
<i>Emërtimi llogarive</i>	<i>Shuma</i>	<i>Emërtimi llogarive</i>	<i>Shuma</i>
Ndërtesat	700.000	Kapitali	900.000
Makineritë	200.000	Kredit i afatgjatë i pagueshëm	200.000
Pajisjet	100.000	Llogaritë e pagueshme	120.000
Inventari i mallit	100.000	Tatimi në fitim i pagueshëm	60.000
Llogaritë e arkëtueshme	80.000	Pagat e pagueshme	20.000
Parapagimet e qirasë	20.000		
Keshi	100.000		
TOTALI I PASURISË	1.300.000	TOTALI I KAPITALI DHE DETYRIMEVE	1.300.000

3.2. Pasqyra e të ardhurave

Raporton, në formë të përmbledhur gjendjet e llogarive të hyrave, shpenzimeve dhe të fitimit neto për një periudhë të caktuar kohore, që zakonisht është një muaj ose një vit. Ndryshe emërtohet si bilanc i suksesit, pasqyrë e fitimit apo humbjes si dhe pasqyrë e shpenzimeve dhe të hyrave.

Qëllimi kryesor i kësaj pasqyre është raportimi i neto fitimit ose neto humbjes së ndërmarrjes për periudhën e caktuar kontabël. Në pasqyrën e të

⁸¹ Dr.sc. Rrustem Asllanaj: "Kontabiliteti financiar", Prishtine, 2010, fq.51.

⁸² Dr.sc. Rrustem Asllanaj: "Kontabiliteti financiar", Prishtine, 2010, fq.53.

ardhurave, të hyrat dhe shpenzimet prezantohen të matura mbi bazën akruale (të realizimit).⁸³

Të hyrat tregojnë rritjen e pasurisë ose zvogëlimin e detyrimeve që kanë rezultuar nga shitja e mallit apo shërbimeve. Ndërsa shpenzimet përfaqësojnë zvogëlimet e pasurisë ose rritjet e detyrimeve, të krijuara nga përdorimi i pasurisë për gjenerimin e të hyrave.

Pasqyra e të ardhurave mund paraqitet në dy formate:

- Formati në shumë hapa dhe
- Formati në një hap.

Formati me një hap për dallim nga formati me shumë hapa, i grupon të gjitha të hyrat në seksionin e parë dhe të gjitha shpenzimet në sesionin e dytë. Totali i shpenzimeve zbritet nga totali i të hyrave dhe raportohet fitimi apo humbje neto e periudhës.

Në vijim paraqitet një shembull i pasqyrës së të ardhurave në formatin e shumë hapave:⁸⁴

Firma "X"	
Pasqyra e të ardhurave me 31.12.20XX	
Të hyrat nga shitja e mallit Kostoja e mallrave të shitura	150.000 (60.000)
Fitimi Bruto	90.000
Shpenzimet e qirasë Shpenzimet e rrymës Shpenzimet e zhvlerësimit	(2.000) (1.000) (17.000)
Fitimi Operativ (EBIT)	70.000
Të hyrat nga kamata Shpenzimet e kamatës	5.000 (3.000)
Fitimi para tatimit (EBT)	72.000
Shpenzimet e tatimit në fitim 20%	(14.400)
Fitimi neto	57.600

3.3. Pasqyra e ndryshimit në kapital

⁸³ Dr.sc. Rustem Asllanaj: "Kontabiliteti financiar", Prishtine, 2010, fq.61.

⁸⁴ Dr.sc. Rustem Asllanaj: "Kontabiliteti financiar", Prishtine, 2010, fq. 64.

Pasqyra e ndryshimit në kapital, raporton informacionet për ndryshimet në gjendjen e kapitalit të kompanisë gjatë një periudhë fiskale. Kjo pasqyrë ndryshe quhet pasqyra e fitimit të mbajtur. Gjendja përfundimtare e fitimit të mbajtur në këtë pasqyrë përfaqëson shumën, e cila raportohet në bilancin e gjendjes brenda kategorisë së kapitalit aksionar. Dy komponentët kryesor, përkatësisht burimet e kapitalit aksionar janë: Kapitali i kontribuar (vetanak) dhe Fitimi i mbajtur.⁸⁵

Shembull i pasqyrës së ndryshimit të kapitalit në vijim:

Firma "X"			
Pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar me 31.12.200X⁸⁶			
Data	Kapitali vet	Fitimi i mbajtur	Kapitali Aksionar
01.01.200X (saldo)	230.000	120.000	350.000
20.02.200X (shitja aksioneve)	100.000	-	100.000
10.05.200X (blerja aksioneve)	(25.000)	-	(25.000)
10.07.200X (deklarimi divid.)		(70.000)	(70.000)
31.12.200X (Fitimi neto i vit.)		100.000	100.000
Saldo me 31.12.200X	305.000	150.000	455.000

3.4. Pasqyra e rrjedhës së parasë

Qëllimi kryesor i pasqyrës së rrjedhave të parasë (keshit) është sigurimi i informacionit për biznesin lidhur me aktivitetet që ndikojnë në hyrjet dhe daljet e parasë gjatë një periudhe fiskale. Me fajllë të tjera, kjo pasqyrë raporton të gjitha transaksionet prej të cilave është gjeneruar paraja si dhe transaksionet për të cilat është përdorur paraja.

Brenda kësaj pasqyre, këto aktivitetet raportohen të klasifikuar mbi bazën e aktiviteteve kryesore të biznesit në tri lloje:⁸⁷

- **Aktivitetet operative** – janë të gjitha aktivitetet primare të biznesit. Si psh. blerja dhe shitja e mallit.
- **Aktivitetet investuese** – janë të gjitha transaksionet që kanë të bëjnë me blerjen dhe shitjen e pasurisë afatgjatë. Si psh. shitja dhe blerja e tokës, impianteve, pajimeve, investimeve financiare, dhenia dhe rikthimi i huave nga firma.
- **Aktivitetet financuese** – i përfshijnë transaksionet e rrjedhave të keshit që lidhen me financimin e brendshëm dhe të jashtëm të

⁸⁵ Dr.sc. Rrustem Asllanaj: "Kontabiliteti financiar", Prishtine, 2010, fq. 75.

⁸⁶ Dr.sc. Rrustem Asllanaj: "Kontabiliteti financiar", Prishtine, 2010, fq. 77.

⁸⁷ Dr.sc. Rrustem Asllanaj: "Kontabiliteti financiar", Prishtine, 2010, fq. 71.

=====

biznesit. Shembuj të aktiviteteve financuese janë: themelimi i biznesit dhe nevoja për sigurimin e kapitalit fillestar, emetimi i aksioneve, obligacioneve, pagesat e aksionareve, etj.

Ndryshe nga bilanci i gjendjes dhe paqyra e te ardhurave, kjo pasyqrë ndërtohet mbi bazën e keshit. Hyrjet ose daljet e kësaj pasqyre janë mjetet në para (arka dhe depozitat monetare në bankë me dhe pa afat pagese) apo ekuivalentët e parasë (letrat me vlerë afatshkurtë).

Përgatitja e pasqyrave të rrjedhës së parasë bëhet në bazë të dy metodave:

- **Metoda direkte** dhe
- **Metoda indirekte.**

Metodat në fjale ndryshojnë ndërmjet tyre vetëm në sesionin e aktivitetit operativ, siç sqarohet në vijim:

Metoda direkte - Aktiviteti operues	Metoda indirekte- Aktiviteti operues
Arkëtimet në kesh nga aktivitetet operuese -Pagesat në kesh nga aktivitetet operuese =Netorrrjedhat e keshit prej aktiv.operues	Fitimi neto + Rregullimet (korigjimet) e fitimit neto = Netorrrjedhat e keshit prej aktiv.operues

Në vijim paraqitet shembull i pasqyrës së rrjedhës së parasë me metodën direkte:⁸⁸

Firma "X"	
Pasqyra e rrjedhave të parasë me 31.12.200X	
Aktivitetet operuese	
Hyrjet në kesh	
Shitja e mallit	165.000
Të hyra nga dividenda	10.000
Të hyra nga komisionet	5.000
Daljet në kesh	
Pagesë ndaj furnitorëve	(80.000)
Për paga të stafit	(20.000)
Për shpenzime publike	(10.000)
Për tatimin në të ardhura të korporatës	(30.000)
Për poliset e sigurimeve	(20.000)
Netorrritjes / pakësimet e keshit prej aktiviteteve operuese	20.000
Aktivitetet investuese	
Hyrjet në kesh	
Shitja e patundshmërisë	50.000
Daljet në kesh	
Për investime në aksione	(60.000)
Për blerjen e makinerive	(30.000)
Netorrritjes / pakësimet e keshit prej aktiviteteve investuese	(40.000)
Aktivitetet financuese	
Hyrjet në kesh	

⁸⁸ Dr.sc. Rrustem Asllanaj: "Kontabiliteti financiar", Prishtine, 2010, fq. 74, 75.

<i>Emetimi i aksioneve</i>	<i>50.000</i>
<i>Huazim nga banka</i>	<i>150.000</i>
Daljet në kesh	
<i>Pagesa e kryegjësë së kreditit</i>	<i>(20.000)</i>
<i>Riblerja e aksioneve të thesarit</i>	<i>(15.000)</i>
<i>Pagesa e dividendës</i>	<i>(20.000)</i>
Netorritjes / pakësimet e keshit prej aktiviteteve financuese	145.000
<i>Neto rrjedhat e keshit gjatë periudhës</i>	<i>125.000</i>
<i>Gjendja e keshit në fillim të periudhës</i>	<i>60.000</i>
Gjendja përfundimtare e keshit me 31.12.200X	185.000

4. Përfundimi

Pasqyrat financiare janë pjesë shumë e rëndësishme e çdo entiteti, pa marrë parasysh veprimtarinë dhe madhësinë. Pa pasqyra financiare nuk mund të dihet gjendja reale e as një zëri ekonomik. Përmes bilancit të gjendjes tregohen asetet, detyrimet dhe kapitali i ndërmarrjes. Përmes pasqyrës së të ardhurave tregohet fitimi neto për periudhën. Përmes pasqyrës së ndryshimeve në ekuit tregohet gjendja dhe krahasimi i kapitalit me periudhat e caktuara kohore. Nëse dëshirojm të dim se sa është keshi, burimi dhe shpenzimi i keshit mund t'a shofim në pasqyrën e rrjedhës së parasë.

Andaj, mund të arrijë në përfundim se secila ndërmarrje duhet të posedoj pasqyra financiare se vetëm atëhere kanë mundësi t'i analizojnë ato dhe të marrin vendime konkrete të cilat mund të jenë shkaktar kryesor të maksimalizimit të fitimit.

5. Literatura

1. Prof. Dr. Rustem Asllanaj "Kontabiliteti financiar", Prishtinë, 2010.
2. Prof. Dr. Skënder Ahmeti "Kontabiliteti financiar", Prishtinë, 2008.
3. Prof. Dr. Sotiraq Dhamo "Kontabiliteti financiar", Tiranë, 2000.
4. Prof. Mr. Drita Shoshi, Ligjeratë e autorizuar, 2004.